



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2021:210581

Datë: 16.01.2024

Numri i dokumentit: 05195231

C.nr.1014/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, nëpërmjet gjyqtarit Robert Tunaj, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leonit Çoçaj, në çështjen juridike të paditësve N.N, N.N, N.N, N.N, N.N të cilët me autorizim i përfaqëson N.N kundër të paditurës N.N me objekt kontesti kompensim i diferencës në pagë lidhur me kualifikimin – licencimin, gjykata me datë 16.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit N.N, N.N, N.N, N.N, N.N, me të cilën kanë kërkuar diferencën në pagë për kualifikim për periudhën 18.04.2017 -21.09.2021.

II. DETYROHET e paditura N.N që në emër të diferencës në pagë lidhur me kualifikimin – licencimin, të paguajë shumën dhe atë:

Për paditësen N.N, për periudhën kohore 21.09.2018 – 21.09.2021, shumën prej 1837.10 euro;

Për paditësen N.N, për periudhën 21.09.2018 – 31.08.2021, shumën prej 1747.20 euro;

Për paditësin N.N, për periudhën 21.09.2018 – 21.09.2021, shumën prej 1992.60 euro;

Për paditësen N.N , për periudhën 21.09.2018 – 01.07.2021, shumën prej 1865.30 euro;

Për paditësen N.N, për periudhën 21.09.2018 – 01.07.2021, shumën prej 1865.30 euro.

Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej **9,307.50 euro (nëntë mijë e treqind e shtatë euro e pesëdhjetë cent)**, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë 21.09.2021, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. REFUZHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë dhe atë për paditësen N.N, sa i përket periudhës kohore 18.04.2017, deri 20.09.2018, në shumën prej 918.52 euro, për paditësen N.N, për periudhën kohore 23.11.2017, deri 20.09.2018 shumën prej 499.20 euro, për paditësin N.N, për periudhën kohore 18.04.2017, deri 20.09.2018, shumën prej 996.30 euro, për paditësen N.N, për periudhën kohore 01.09.2017, deri 20.09.2018, shumën prej 680.80 euro, si dhe për paditësen N.N, për periudhën kohore 22.11.2017, deri 20.09.2018, shumën prej 514.75 euro, shkak të kalimit të afatit të parashkrimit.

IV. OBLIGOHET e paditura N.N, që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë shumën prej 649.00 euro, në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Arsyetim

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, pranë kësaj gjykate me 21.09.2021, kanë parashtruar padi kundër N.N, me të cilën kanë kërkuar kompensimin në pagë lidhur me avancimin në karrierë dhe zhvillim profesional konform Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, nga viti 2017. Shpenzimet gjyqësore i ka kërkuar.

I autorizuari i paditësve me datë 17.11.2023, ka paraqitur pranë gjykatës parashtresën me numër C.nr.1014/2021, me të cilën e ka bërë zgjerimin – ndryshimin e padisë, në kuptimin objektiv, konkretisht dhe atë duke përcaktuar periudhën kohore dhe shumën për secilin paditës, konkretisht për paditësen N.N , për periudhën kohore 18.04.2017 – 21.09.2021, shumën prej 2755.62 euro, për paditësen N.N, për periudhën 23.11.2017 – 31.08.2021, shumën prej 2,246.40 euro, për paditësin N.N , për periudhën 18.04.2017 – 21.09.2021, shumën prej 2,988.90 euro, për paditësen N.N, periudhën 01.09.2017 – 01.07.2021, shumën prej 2,546.10 euro, si dhe për paditësen N.N, për periudhën 22.11.2017 – 01.07.2021, shumën prej 2,380.05 euro.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës, me datë 09.11.2023 pranë kësaj gjykate ka parashtruar përgjigje në padi, me të cilën ka theksuar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësve lidhur me kompensimin e pagës, konform licencimit – kualifikimit, pasi që në rastin konkret paditësit kanë nënshkruar kontratën e punës, në të cilën janë të përcaktuara të drejtat dhe detyrimet e palëve nënshkruese, duke përfshirë edhe pagën. Andaj, sipas tij të gjitha obligimet që dalin nga kontrata e punës, këtu e paditura i ka përmblushur, duke llogaritur edhe çështjen e gradimit. Gjithashtu, ka theksuar se kërkesa e paditësve në rastin konkret është e pabazë, ngase nuk posedon licencë të mësimdhënies. Gjithashtu, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, i njëjti ka theksuar se të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje kontestuese, ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesë padinë”* dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga e paditura, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi ka qenë në marrëdhënie të punës tek e paditura.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se të gjithë paditësit N.N.

Këtë fakt, gjykata e vërtetoi përmes provave dhe atë:

Për paditësen N.N –

Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Edukimit Qendra në Prizren, me numër 277, e datës 24 mars 2015, me të cilën vërtetohet se paditësja ka mbaruar studimet në Programin fillor, me gjithsej 240 kredi – ECTS.

Kontrata e punës me numër protokolli 314, e datës 01.09.2015, me të cilën vërtetohet se paditësja N.N, me pagë mujore 405.00 euro, në emër të gradimit është aguar shuma mujore prej 58,32€.

Vërtetimi i lëshuar nga SH.F.M.U. “Besim Ndrecaj”, në fshatin Maqitevë, Komuna e Suharekës, me numër 59/21, i datës 01.07.2021, me të cilën vërtetohet se paditësja është mësimdhënëse pranë kësaj shkolle që nga data 01.09.1990, ku ende punon.

Licenca e punës me numër 100010133, në emër të paditëses, e cila ka validitet nga data 01.03.2013 – 01.03.2018.

Për paditësen N.N-

Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Fakulteti i Edukimit, me numër 466, e datës 17 shtator 2016, me të cilën vërtetohet se paditësja ka mbaruar studimet në Programin Gjuhë dhe Letërsi Angleze, me gjithsej 240 kredi – ECTS.

Kontrata e punës me numër protokolli 02, e datës 02.09.2019, me të cilën vërtetohet se paditësja N.N, me pagë mujore 378.90 euro, në emër të gradimit është aguar shuma mujore prej 52,38€.

Vërtetimi i lëshuar nga SH.F.M.U. “Besim Ndrecaj”, në fshatin Maqitevë, Komuna e Suharekës, me numër 71/21, i datës 01.07.2021, me të cilën vërtetohet se paditësja është mësimdhënëse pranë kësaj shkolle që nga data 23.11.2017, ku ende punon.

Licenca e punës me numër 1028998, në emër të paditëses, e cila ka validitet nga data 24.03.2021 – 24.03.2026.

Për paditësin N.N–

Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i shkencave matematike – natyrore, me numër 601, i datës 08 shkurt 2006, me të cilën vërtetohet se paditësi ka mbaruar studimet në Degën e Biologjisë, dhe mori titullin Profesor i Biologjisë.

Kontrata e punës me numër protokolli 45/2021, e datës 30.04.2021, me të cilën vërtetohet se paditësi N.N me pagë mujore 421 euro, në emër të gradimit është aguar shuma mujore prej 58,32€.

Vërtetimi i lëshuar nga SH.F.M.U. “Besim Ndrecaj”, në fshatin Maqitevë, Komuna e Suharekës, me numër 61/21, i datës 01.07.2021, me të cilën vërtetohet se paditësi është mësimdhënësi pranë kësaj shkolle që nga data 01.09.1989, ku ende punon.

Licenca e punës me numër 100010128, në emër të paditësit, e cila ka validitet nga data 01.03.2013 – 01.03.2018.

Për paditësen N.N -

Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Fakulteti i Edukimit, me numër 610, e datës 21 prill 2017, me të cilën vërtetohet se paditësja ka mbaruar studimet në Programin Fillor – Gjuhë Shqipe, me gjithsej 240 kredi – ECTS.

Kontrata e punës me numër protokolli 06/2020, e datës 02.10.2020, me të cilën vërtetohet se paditësja N.N , me pagë mujore 421 euro, në emër të gradimit është aguar shuma mujore prej 58,32€.

Vërtetimi i lëshuar nga SH.F.M.U. “Besim Ndrecaj”, në fshatin Maqitevë, Komuna e Suharekës, me numër 70/21, i datës 01.07.2021, me të cilën vërtetohet se paditësja është mësimdhënëse pranë kësaj shkolle që nga data 01.09.2017, ku ende punon.

Licenca e punës me numër 1028999, në emër të paditëses, e cila ka validitet nga data 24.03.2021 – 24.03.2026.

Për paditësen N.N -

Diploma e lëshuar nga Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, Fakulteti i Edukimit, me numër 377, e datës 22 korrik 2016, me të cilën vërtetohet se paditësja ka mbaruar studimet në Programin Fillor – Gjuhë Shqipe, me gjithsej 240 kredi – ECTS.

Kontrata e punës me numër protokolli 15, e datës 01.10.2018, me të cilën vërtetohet se paditësja N.N, me pagë mujore 421 euro.

Vërtetimi i lëshuar nga SH.F.M.U. “Besim Ndrecaj”, në fshatin Maqitevë, Komuna e Suharekës, me numër 69/21, i datës 01.07.2021, me të cilën vërtetohet se paditësja është mësimdhënëse pranë kësaj shkolle që nga data 22.11.2017, ku ende punon.

Licenca e punës me numër 1029001, në emër të paditëses, e cila ka validitet nga data 24.03.2021 – 24.03.2026.

Gjykata, me rastin e aprovimit të pjesshëm të kërkesëpadisë së paditëses dhe përcaktimit të lartësisë për kompensimin e diferencës në pagë për punonjësin me licencim-kualifikim, është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, e nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me numër 01/33, të datës 29.08.2008.

Sipas dispozitës së nenit 7 paragrafi 1, pika 3 dhe pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e datës 18.04.2017, është paraparë se: *“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katërvjeçar, 27 % e pagës bazë.*

Gjithashtu, në bazë të kontratës kolektive të arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, në nenin 7 për licencim thuhet se: *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e licencës së fituar, bazuar në UA Nr. 5/2017 Sistemi i licencimit dhe i zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë, u mundëson mësimdhënësve realizimin e stimulimit në të ardhurat personale, si vijon: 1.1 Mësimdhënës me Licencë të karrierës 10 % e pagës bazë. 1.2 Mësimdhënës me Licencë të avancuar 10% e pagës bazë. 1.3 Mësimdhënës me Licencë mentor 15% e pagës bazë. 7 1.4 Mësimdhënës me Licencë meritor 15% e pagës bazë”.*

Në vendimin e Qeverisë Nr.01/33, të datës 29.08.2008, në paragrafin 4 pika 2 dhe 3, përcaktohet se *“Mësimdhënësit me Diplomë Universitare 3 dhe 4 vite fitojnë ngritje të pagës bazë për 27%.*

Gjithashtu, edhe në bazë të Mendimit Juridik, me nr.prot.214/2013, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, është paraparë se dispozita e nenit 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 17.04.2017 dhe Kontratës në fuqi të datës 22.01.2021, ka karakter detyrues, për palët nënshkruese, në rastin konkret për të paditurën Komunën e Suharekës.

Duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, si dhe dispozitave tjera ligjore dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e aprovoj në mënyrë të

pjesëshme kërkesëpadinë e paditësve dhe e detyroi të paditurën, që t'ia paguaj shumën monetare dhe atë: Për paditësen N.N për periudhën kohore 21.09.2018 – 21.09.2021, shumën prej 1837.10 euro, Për paditësen N.N, për periudhën 21.09.2018 – 31.08.2021, shumën prej 1747.20 euro, Për paditësin N.N, për periudhën 21.09.2018 – 21.09.2021, shumën prej 1992.60 euro, Për paditësen N.N, për periudhën 21.09.2018 – 01.07.2021, shumën prej 1865.30 euro, si dhe Për paditësen N.N, për periudhën 21.09.2018 – 01.07.2021, shumën prej 1865.30 euro, Të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej **9,307.50 euro (nëntë mijë e treqind e shtatë euro e pesëdhjetë cent)**, duke llogaritur kamatën ligjore në lartësi prej 8% nga dita e dorëzimit të padisë në gjykatë 21.09.2021, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Kjo, pasi që e paditura nuk e ka përbushur obligimin e tij, siç e ka pasur detyrim sipas Kontratës Kolektive të Arsimit, në Kosovë, të datës 18.04.2017.

Kjo vlerë ka ardhur duke llogaritur në bazë të formulës: Paga bazë * përqindja konform licencimit barazim vlera - diferenca e paguar x periudha kohore = shuma e përgjithshme.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marrë parasysh faktin se paditësi me rastin e parashtrimit të kërkesëpadisë, ka kërkuar ti njihet e drejta e kompensimit në pagë bazuar në kualifikim – licencim, prej datës 18.04.2017. Mirëpo, me rastin e kalkulimit të periudhës kohore të kërkuar nga datat e lartcekura, gjykata ka ardhur në përfundim se për periudhën e lartëcekur, të kërkuar si në kërkesëpadi, ka kaluar afati i parashkrimit prej momentit të parashtrimit të kërkesëpadisë (21.09.2021), pasi që bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, thuhet se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Andaj, lidhur me këtë është vendosur të refuzohet pjesa tjetër e kërkesëpadisë dhe atë për paditësen N.N, sa i përket periudhës kohore 18.04.2017, deri 20.09.2018, në shumën prej 918.52 euro, për paditësen N.N, për periudhën kohore 23.11.2017, deri 20.09.2018 shumën prej 499.20 euro, për paditësin N.N, për periudhën kohore 18.04.2017, deri 20.09.2018, shumën prej 996.30 euro, për paditësen N.N, për periudhën kohore 01.09.2017, deri 20.09.2018, shumën prej 680.80 euro, si dhe për paditësen N.N, për periudhën kohore 22.11.2017, deri 20.09.2018, shumën prej 514.75 euro shkak të kalimit të afatit të parashkrimit.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 312.00 euro, përpilimi i ndryshimit të padisë 312 euro si dhe taksës gjyqësore prej 21.00 euro, në shumën e përgjithshme prej 649.00 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.1014/2021, dt. 16.01.2024**

**Gjyqtari
Robert Tunaj**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.